

FLETËPALOSJE - INFORMACION PËR PËRDORUESIT

ALERINIT tabletë 5 mg e veshur me cipë të hollë.



Për përdorim nga goja

- **Principi aktiv:** Cdo tabletë e veshur me cipë përmban 5 mg levocetirizine dihidrokloride
- **Eksipientë:** Celulozë mirocrystalline, laktozë monohidrat, silikon koloidal anhidroz, stearat magnezi, hipromelozë (E464), hipromelozë (E171), dioksid titiumi, makrogol 400, polisorbat 80 (E433)

Lexoni me kujdes te gjithë këtë fletëpalosje para se të nisni përdorimin e këtij bari, sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.

- Mbajeni këtë fletëpalosje. Mund të keni nevojë ta lexoni sërish.*
- Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme, konsultoni mjekun tuaj ose farmacistin.*
- Ky bar është përshkruar vetëm për ju, mos ua sygjeroni personave të tjerë.*
- Informoni mjekun tuaj që jeni duke u trajtuar më këtë bar, në rast se bëni vizitë tek mjeku ose jeni në spital.*
- Ndiqni rreptësisht udhëzimet në këtë fletëpalosje informative. Mos përdorni doza më të larta ose më të ulëta, përveç se ajo që është rekomanduar për ju.*

Në këtë fletëpalosje:

1 Çfarë është ALERINIT dhe përse përdoret?

2 Përpara se të përdorni ALERINIT

3 Si ta përdorni ALERINIT?

4 Cilat janë efektet e mundshme anësore ?

5 Si të ruani ALERINIT?

Janë përfshirë.

1. Çfarë është ALERINIT dhe përse përdoret?

- ALERINIT është një antihistaminik i përdorur në trajtimin e alergjive. Bari antihistaminik përjashton pasojat e efekteve histaminike, dhe eliminon simptomat alergjike.
- ALERINIT është i disponueshëm në paketa me blistera që përmbajnë 20 tableta, së bashku me këtë fletëpalosje.
- ALERINIT rekomandohet për eliminimin e rinitit alergjik, (simptomave sporadike / të vazhdueshme, ose sezonale / kronike) dhe për simptomat e lidhura me urtikariet idiopatike kronike, me natyrë të panjohur (të tilla si kruajtje, ënjtje, skuqje), tek fëmijët e moshës 6 vjeç e sipër dhe tek të rriturit.

2. Përpara se të përdorni ALERINIT

Ju lutem, mos e merrni ALERINIT:

Nëse:

- Ju jeni alergjik (tepër i ndjeshëm) ndaj levocetirizine dihidroklorid, apo ndonjë nga përbërësit tjerë të ALERINIT,
- Ju keni një dëmtim të rëndë të funksionit të veshkave (insuficiencë të rëndë të veshkave me pastrim të kreatininës nën nivelin 10 ml / min).

Tregoni kujdes të veçantë me ALERINIT:

- ALERINIT nuk rekomandohet për foshnjat dhe fëmijët nën 6 moshën vjeç.
- ALERINIT përmban laktozë. Nëse mjeku juaj, ju ka informuar se ju nuk mund të toleroni ndonjë nga sheqërnat, ju lutem kontaktoni me mjekun tuaj, përpara këtij bari.
- Ju lutem jini të kujdesshëm, nëse e merrni ALERINIT në të njëjtën kohë me alkool, Në ata pacientë të ndjeshmëm, përdorimi i njëkohshëm i cetirizinës ose levocetirizinës me alkool, mund të ndikojë në vetëdije.

Nëse, ndonjë prej këtyre paralajmërimeve përputhet me gjendjen tuaj të tanishme, apo me çdo periudhë në të kaluarën, ju lutemi të konsultoheni me mjekun tuaj.

Përdorimi i ALERINIT me ushqim dhe pije

Ju mund ta merrni ALERINIT shoqëruar me ushqim dhe pije.

Shtatzënia:

- Përpara se të merrni këtë bar, konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.
- Nuk duhet të përdoret në gratë shtatzëna

- Bari, mund të përdoret vetëm me recetën e mjekut tuaj, por, pasi janë vlerësuar treguesit e rrezikut / përfitimit.
- Në rast se ju vini re se, gjatë terapisë tuaj, jeni shtatzënë, konsultohuni me mjekun tuaj menjëherë.

Ushqyerja me gji:

- Përpara se të merrni këtë bar, konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.
- Bari nuk duhet të merret gjatë periudhës së ushqyerjes me gji, pasi cetirizina ekskretohet/kalon në qumëshin e nënës.

Drejtimi dhe përdorimi i makinerive

Disa prej pacientëve që përdorin ALERINIT, ndjejnë mpirje, këputje dhe mbilodhje/shterim të fuqive. Nëse keni ndërmend të kryeni veprimtari të vështirë/të rrezikshme, të drejtoni makinën, ose të përdorni makineri, rekomandohet të prisni reagimin trupit tuaj ndaj barit dhe të jeni të kujdesshëm.

Informacion i rëndësishëm në lidhje me disa përbërës të ALERINIT

ALERINIT përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj, që keni intolerancë për lloje të caktuara të sheqerit, kontaktoni me mjekun tuaj para se të merrni këtë produkt.

Përdorimi me barna të tjera

Në ata pacientë me ndjeshmëri, përdorimi i njëkohshëm i cetirizinës ose levocetirizinës me alkool, mund të ndikojë në vetëdije.

Në qoftë se aktualisht, apo së fundmi, merrni, ose keni marrë ndonjë bar të përshkruar (me recetë) ose barna OTC (pa recetë), ju lutem informoni mjekun ose farmacistin tuaj

3 Si ta përdorni ALERINIT?

Udhëzime për përdorimin e duhur dhe shpëstësinë e dozës

- Ju lutemi, përdoreni gjithmonë ALERINIT, ashtu siç ju ua ka rekomanduar mjeku juaj Nëse ju nuk jeni të sigurt, ju duhet të kontaktoni mjekun ose farmacistin.

Në fëmijët midis moshës 6-12 vjeç: Një herë në ditë, 5 mg tabletë të veshur me cipë,.

Në të rriturit dhe fëmijët e moshës 12 vjeç e sipër: Një herë në ditë, 5 mg tabletë të veshur me cipë.

Rruga dhe mënyra e përdorimit:

- ALERINIT merret nga goja.
- Gëlltiteni të gjithë tabletën, shoqëruar me një gotë ujë. Doza ditore rekomandohet të merret një herë në ditë.
- ALERINIT mund të merret me / ose / jo me ushqim.

Grupmosha të ndryshme :

Përdorimi në fëmijë:

Për shkak të faktit se nuk ka të dhëna në dispozicion për trajtimin e fëmijëve dhe foshnjave me këtë bar, *në pacientët nën 2 vjeç, nuk rekomandohet përdorimi i këtij mjekimi.*

Në fëmijët nën 6 vjeç, rregullimi i dozës së tabletës, nuk është i mundur dhe nuk është i rekomanduar.

Përdorimi geriatric (tek të moshuarit) :

Në ata pacientë me funksione normale të veshkave, nuk është i nevojshëm rregullimi i dozës.

Përdorimi specifik:

Insufiçenca renale / hepatike:

- Në ata pacientë me insufiçencë renale, mund të jepen doza më të ulëta, në përputhje me gjendjen e sëmundjes.

Tek fëmijët, doza rregullohet sipas peshës trupore. Doza do të përcaktohet nga mjeku juaj;

- Mos e përdorin barin, nëse keni insufiçencë të rëndë të veshkave;
- Nëse keni insufiçencë hepatike, ju mund ta përdorni barin në dozat e sygjera.
- Në ato pacientët që i shfaqin të dyja, si insufiçencen renale ashtu edhe atë hepatike, doza mund të jepet në përputhje me shkallën e rëndesës së sëmundjes së veshkave.

Tek fëmijët, doza rregullohet sipas peshës trupore. Doza do të përcaktohet nga mjeku juaj.

Kohëzgjatja e trajtimit me ALERINIT ,do të përcaktohet nga mjeku juaj, duke marrë parasysh ankesat, kohëzgjatjen dhe llojin e sëmundjes.

Nëse mjeku juaj nuk sugjeron ndonjë gjë tjetër, ju lutem ndiqni këto udhëzime:

Ju lutemi merreni barin tuaj në kohën e përcaktuar.

Nëse keni vene re se, ALERINIT ka efekt shumë të fortë, apo shumë të dobët, ju lutemi konsultohuni me mjekun ose farmacistin.

Nëse ju merrni më shumë ALERINIT se ju duhet:

Nëse ju merrni më shumë sasi të ALERINIT, se sa ju duhet, konsultohuni me një mjek ose farmacist.

Mpirje/mungesë reagimi mund të shfaqet te të rriturit. Nervozizëm dhe mpirje mund të shfaqen tek fëmijët.

Nëse ju harroni të merrni ALERINIT

Nëse ju harroni të merrni dozën tuaj në kohë, ose, merrni një dozë më të ulët, sesa ajo e përshkruar nga mjeku juaj, ju lutemi, dozat pasuese vazhdoni t'i merrni rregullisht.

Mos merrni një dozë të dyfishtë për të zëvendësuar dozën e harruar.

Efektet e mundshme pas ndërprerjes së terapisë me ALERINIT

Nëse e keni përdorur ALERINIT për një afat më të shkurtër sesa ai i sygjjeruari për ju, nuk priten efekte të rrezikshme. Megjithatë, në një rast të tillë, simptomat mund të ndodhin më pak, se para trajtimit me ALERINIT.

4 Cilat janë efektet e mundshme anësore?

Ashtu si të gjithë barnat, pacientët me ndjeshmëri ndaj përbërësve të ALERINIT, mund të përjetojnë efekte anësore.

Në qoftë se ju përballeni me një nga rastet e mëposhtme, ndërprisni përdorimin e ALERINIT dhe informoni menjëherë mjekun tuaj, ose shkoni në shërbimin të afërt të urgjencës:

- Reaksion alergjik (reagim hipersensitiviteti)
- Kriza të manifestuara me konvulsione të rënda, të papritura;
- Hepatit
- Funksion jonormal hepatic
- Rrahje zemre
- Ngulçe respiratore

- Çrregullim pamor
- Takikardi

Këto janë efekte shumë të rënda anësore. Nëse keni ndonjë nga këto simptoma, kjo do të thotë që, ju keni alergji serioze ndaj ALERINIT. Ju mund të keni nevojë për ndërhyrje të menjëhershme mjekësore, ose mund të jetë e nevojshme mbikqyrja në kushte spitalore.

Këto efekte të rënda anësore janë shumë të rralla.

Nëse vëreni simptomat e mëposhtme, tregoni mjekut tuaj:

- Tharje goje (Kserostomia);
- Dhimbje koke;
- Lodhje;
- Përgjumje (Somnolencë) /pasivitet;
- Pafuqi ekstreme;
- Dhimbje stomaku;
- Edema/Ënjtje;
- Kruarje të rënda;
- Njolla/puçra të kuqe në lëkurë/Rash;
- Urtikarie;
- Shtim në peshë;
- Dhimbje të muskujve;
- Agresivitet apo gjendje e rëndë aksiozë;
- Të përzjera;
- Haluçinacione;
- Depresion.

Këto janë efektet e buta anësore të ALERINIT.

Nëse vini re ndonjë efekt anësor, i cili nuk sygjerohet në këtë fletëpalosje, ju lutem, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. Si ta ruajmë ALERINIT

Ruajeni ALERINIT në paketë dhe mbajeni jashtë kontaktit dhe shikimit të fëmijëve.

Ruajeni ALERINIT në temperaturën e dhomës, më poshtë se 25°C.

Përdoreni në përputhje me datën e skadimit.

Mbajeni në paketën origjinale.

Mos e përdorni ALERINIT pas afatit të skadencës të shënuar në paketë.

Mos e përdorni ALRINAST, në rast se vini re ndonjë dëmtim në bar dhe / ose në paketë dhe informoni farmacistin tuaj, ose mjekun.

Mbajtësi i licencës:

Ilko ILAC San. ve Tic. A. s. Veysel Karani Mah. Colakoglu Sok. No: 10, 34885
Sancaktepe / İstanbul, Turkey

Vendi i prodhimit:

Ilko ILAC San. ve Tic. A. s. A.Ş. 3.Organize Sanayi Bolgesi Kuddusi Cad. 23. Sok.
No: 1 Selcuklu / Konya, Turkey